



Alberta Burslem



B

Brunilda Riza
Osida Monopati Iluf

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1073/2 Prot.

Vlorë më, 02.05.2024

VENDIM

Nr. 21, datë 02.05.2024

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL NË TERAPI ZHVILLIMI PËR PERSONAT ME NEVOJA TË
VEÇANTA" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja dh, nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën 1000 prot, datë 24.04.2024 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 02.05.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Edukimit në Fakultetin e Shkencave Humane për hapjen e programit të studimit "Master Profesional në Terapi Zhvillimi për Personat me Nevoja të Veçanta" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit, Zëvendësrektorit Akademik, Drejtoria e Edukimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Asoc. Xhiliola Agaraj (Shehu)

